



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400116/6

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Drejtorit të IEVP Durrës Z. Astrit Kotaj*

Drejtuar : **Z. Atur ZOTO**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

Tiranë

I nderuar Zoti Zotaj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi i dënuar B.A. Ai shkruan se, që në muajin shtator 2013 ndodhet në IEVP Durrës. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në muajin nëntor 2013 është marrë vendim për ekstradimin e tij në Itali. Sipas ankuesit, megjithëse ka rreth 4 muaj që vendimi ka marrë formë të prerë ai nuk po ekstradohet akoma. Gjithashtu ankuesi pretendon se, nga juristi i IEVP-së nuk sqarohet lidhur me shkaqet e zvarritjeve të procedurës së ekstradimit të tij.

Për të zgjidhur këtë ankesë, bazuar në pikën 4, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij; në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe konkretisht, në nenin 19, gërma "b" ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin"; si dhe në nenin 19, paragrafi i fundit, ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme", me shkresën Nr. K2/B4-2 prot., datë 31.01.2014 i kërkuam Drejtorit të IEVP Durrës Z. Astrit Kotaj që të verifikonte atë dhe të na dërgonte shpjegime lidhur me pretendimet e parashtruara nga ankuesi.*

Ndonëse afati ligjor për kthimin e përgjigjes së shkresës tonë kaloi ai nuk na e dërgoi atë.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e rastit të ankuesit u detyruam që me shkresën Nr. K2/B4-4 prot., datë 26.02.2014 ta përsërisnim kërkesën tonë.

Ndërkohë nëpërmjet kësaj shkrese i kujtuam atij se detyrimi i organeve

të administratës publike për të bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit dhe për t'i kthyer përgjigje kërkesave të tij është parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj. Gjithashtu i bëmë të ditur se ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", në nenin 22/1 të tij parashikon edhe të drejtën e Avokatit të Popullit për të kërkuar masa disiplinore ndaj punonjësve të administratës publike të cilët nuk bashkëpunojnë me të.

Megjithatë, edhe pas kërkesës së dytë ai përsëri nuk na e dërgoj përgjigjen e kërkuar nga ana jonë. Moskthimi i përgjigjes së kërkuar nga Avokati i Popullit është një nga rastet tipike të mosbashkëpunimit të punonjësve të administratës publike me institucionin e Avokatit të Popullit.

Ky qëndrim i Drejtorit të IEVP Durrës me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankuesit. Ndërkohë ai cënon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1 të ligjit "Për Avokatin e Popullit" ku parashikohet se: *"Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil"*,

KËRKOJMË:

1. Fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Drejtorit të IEVP Durrës Z. Astrit Kotaj.
2. Ky rast të përgjithësohet dhe t'u bëhet i njohur gjithë drejtuesve të IEVP-ve në vend me qëllim që të mos përsëritet më në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë dhe masën disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi
Nd/KOMISIONER

Frederik PASKALI